

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
PRILL – SHTATOR 2022**

Nr. rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e Përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	05.04.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723,datë 03.05.2007,“Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: A.GJ	11.04.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 7048, Prot, datë 11.03.2022, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr. 1032 Prot, datë 05.04.2022 “Kërkim informacioni,ju informojmë se subjekti A.Gj person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me administrator z. A.Gj regjistruar me datë 30/09/2015 ne QKR, me aktivitet në fushën Bar-Kafe, me adresë Shkoder Shkrel REC Lagjja Kuç, Rruga Reç, godine 2- kateshe, nr. 1, Malësi e Madhe, ka detyrime fiskale vendore në vleren 64.890 lekë ndaj Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Malësi e Madhe.	Përfunduar	Nuk ka
2	05.04.2022	Ne zbatim te Urdhrit Nr 49 date 21.09.2021 “Per ngritjen e grupit te punes	11.04.2022	Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore“ si dhe nisur nga shkresa Nr. 72/1 Prot., datë	Përfunduar	Nuk ka

		<p>per evidentimin e statusit te pronesise /administrimit dhe gjendjes fizike te ambjenteve ku ushtrojne aktivitetin Zyrat Rajonale Statistikore” dhe aplikimit online ne portalin e-albania prane ASHK sipas kerkeses nr 427 date 24.03.2022 kerkojme nga ana juaj informacion zyrtar mbi numrin e pasurise ku ushtron aktivitetin Zyra Statistikes Malesi e Madhe Duke qene se nga viti 2004 Zyra e Statistikes Malesi e Madhe ushtron aktivitetin ne te njejten vendodhje,bashkengjitur per orientim vertetim mbi vendodhjen nr 471 Prot date 01.09.2015 si dhe plan rivelim I kesaj date leshuar nga Zyra e Kadastres Malesi e Madhe</p>		<p>31.03.2022, administruar pranë institucionit tonë me Nr. 1038 Prot. datë 05.04.2022, ku kërkohet informacion në lidhje me numrin e pasurisë ku ndodhet Zyra e Statistikës Malësi e Madhe: Ju bëjmë me dije se bazuar në materialet që na keni vënë në dispozicion dhe sipas listës së trojeve të qytetit të Koplikut që disponon zyra e Kadastrës në Bashkisë, rezulton që objekti i Zyrës së Statistikës Malësi e Madhe pozicionohet në pasurinë me numër 6/157 ZK 2220. Bashkangjitur gjeni një fragment harte për pasurinë në fjalë.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

3	11.04.2022	<p>Në lidhje me veprimet hetimore paraprake që po kryhen për proçedimin penal nr.1210 të vitit 2021 nevojitet nga ana e juaj të na konfirmohet nëse vendi i quajtur</p> <p>Lagje: "Jugomirë" fshati Bratosh, në Njësinë Administrative Kastrat, Bashkia Malësi e Madhe i përket një parcele nën administrimin e Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore Malësi e Madhe dhe në rast se po të na furnizohen gjeneralitetet dhe adresa e saktë e vendbanimit e inspektorit të pyjeve që mbulon këtë zonë duke specifikuar dhe datën e</p>	19.04.2022	<p>Për sa kërkoni ne shkresën tuaj Nr. 3123 Prot. Date 08.04.2022 e administruar nga ana jone me shkresën Nr.1085 Prot. Date 11.04.2022 ju sqarojmë si me poshtë :</p> <p>Territori ne vendin e quajtur "Lagje "Jugomire "Fshati Bratosh, ne Njësinë Administrative Kastrat si fshat i kësaj Njësie Administrative ndodhet ne toka bujqësore por ne afërsi te tyre gjenden ngastrat dhe n/gastrat e Ekonomisë Pyjore Kastrat - Zagore ne administrim Drejtorisë se Pyjeve pjese e Bashkisë Malësia e Madhe. Inspektori i Pyjeve qe mbulon ketë zone eshte Z. Ndue Bakaj i cili e ka marre detyren qe nga dt.20.05.2020</p> <p>Bashkëngjitur ju dërgojmë edhe hartën e territorit ku gjendet vendi i përshkruar si me sipër.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		marrjes së kësaj detyre nga ana e tij.				
4	21.04.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: D.U	10.05.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 10448, Prot, datë 13.04.2022, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr. 1193 Prot, datë 21.04.2022 “Kërkim informacioni, ju informojmë se subjekti D.U person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me administrator z. D.U regjistruar me datë 21/09/2015 në QKR, me aktivitet në fushën Bar-Kafe, me adresë Shkoder, Koplik, Koplik i Siperm, Rruga Shkoder Koplik, zona kadastrale 2221, nr.pasurie 788, Malësi e Madhe, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Malësi e Madhe.	Përfunduar	Nuk ka

5	29.04.2022	Bazuar në nenin 57, pika 2, të ligjit Nr. 155/2015, datë 21.12.2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar),"Bashkëpunimi i AMLF-së me strukturat e tjera shtetërore", kërkojme nga ana juaj të na informoni, mbi shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, të subjektit të lojërave të fatit "TOP BAST" sh.a. me Nipt:XXXXXXXXXX	10.05.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.694.Prot, datë 26.04.2022 "Kërkesë për informacion", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr. 1274 Prot, datë 29.04.2022, në zbatim të ligjit nr 9920 datë 19.05.2008. "Për proçedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë ", ju informojmë se subjekti "TOP BAST" sh.a me Nipt: XXXXXXXXXXXX, nuk ka detyrime për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Malesi e Madhe.	Përfunduar	Nuk ka
6.	06.05.2022	Per sa me siper kërkojme informacion për pasurine në ZK 1244 në emer të Z.Q.LI.P si dhe statusin juridik, kartelat e pasurisë dhe certifikatë pronësie nëse kanë për pasuritë me nr, 144,169,824 dhe 709.Ky informacion kerkohet për ta paraqitur në proçesin gjyqësor të sipërcituar.	13.05.2022	Në përgjigje të kërkesës nr. 754, dt. 09.05.2022 të bërë nga ana juaj për informacion zyrtar dhe shkresës nr.1332 dt.06.05.2022 në lidhje me pasuritë me nr .144; 169; 824; dhe 709 ndodhur në Z.K. 1244 Boriç i Madh, në emër të Z. Q.H.P ju bëjmë me dije se: Pasuria nr. 144 - vol. 1 fq. 144, Z.K. 1244 me sip. 6.350 m2 me zë kadastral Arë, me pronar Z. Q.H.P, Çertifikuar me datë 10.01.2003 mbi bazën e AMTP-së nr.13. Pasuria nr. 169 - vol. 1 fq. 169, Z.K. 1244 me sip.	Përfunduar	Nuk ka

				6.750 m2 me zë kadastral Arë, me pronar Z. Q.H.P Çertifikuar me datë 10.01.2003 mbi bazën e AMTP-së nr.13. Pasuria nr. 824 - vol. 4 fq. 150, Z.K. 1244 me sip. 16.230 m2 me zë kadastral Arë, me pronar Z. Q.H.P Çertifikuar me datë 10.01.2003 mbi bazën e AMTP-së nr.13. Pasuria nr. 709 - vol. 3 fq. 209, Z.K. 1244 me sip. 9.547 m2 me zë kadastral Arë+Truall, me pronar Z. Q.H.P Çertifikuar me datë 10.01.2003 mbi bazën e AMTP-së nr. 13.		
7	10.05.2022	Në zbatim të shkresës nr. 2458 prot. datë 11.04.2022 të Ministrisë së Arsimit “Për verifikimin e drejtuesve didaktikë”, kërkojmë nga ana juaj verifikimin dhe dhënien e informacionit për sa më poshtë: - A është e punësuar në ndonjë kopësht publik, Znj. D. F.P	20.05.2022	Në përgjigje të shkresës suaj nr.271 prot datë 19.04.2022, protokolluar në institucionin tonë me nr. 1387 datë 10.05.2022, ju informojmë se pas verifikimit të bëre rezulton se Znj.D.F.P nuk është e punësuar në asnjë nga kopshtet publike të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Malësi e Madhe. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!	Përfunduar	Nuk ka
8	16.05.2022	Në mbështetje të ligjit 7889 datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit të punës“ kërkojmë nga ana juaj të na pajisni me modularët e	02.06.2022	Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1444 datë 16.05.2022, protokolluar me nr.2282 datë 18.05.2022 po ju dërgojmë vertetimin tip dublikatë me nr; 388 datë 22.12.2017 për Znj.	Përfunduar	Nuk ka

		invalidit të punës sipas dokumentacionit bashkëngjitur:		N.O.R sipas periudhës së kërkuar nga ana juaj. Faleminderit për bashkëpunimin!		
9	25.05.2022	<p>Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në funksion të veprimtarisë së tij për promovimin e një shoqërie me mundësi dhe shanse të barabarta dhe duke luftuar çdo veprim apo mosveprim që sjell diskriminim, synon të ndërmarre të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar, për t'i garantuar të drejtën për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminim.</p> <p>Bazuar në Ligjin nr. 10 221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Ligjit nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", Ligjit nr. 15/2019</p>	5.08.2022	<p>I nderuar Z.Gajda,</p> <p>Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.792 Prot datë 23.05.2022, protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1574 Prot datë 25.05.2022, mbi kërkesën për informacion në lidhje me përfshirjen në punësim të personave me aftësi të kufizuar, bazuar në Ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjin nr.93/2014 "Për Nxitjen e Punësimit", Ligjin nr.7961,datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bashkëngjitur po ju dërgojmë përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit të dërguar nga ana juaj.</p> <p>a) Numri total i personave të punësuar në strukturën e Institucionit të Bashkisë Malësi e Madhe, Njësi Administrative dhe Funksioneve të Deleguara është 428 (katërqind e njëzet e tetë) nga të cilët 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) janë meshkuj dhe 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) janë femra.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>“Për Nxjitjen e Punësimit”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për t’i ofruar akses të barabartë në punësim dhe informacion personave me aftësi të kufizuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është duke kryer një monitorim dhe ka përgatitur pyetësonin për organet e qeverisjes vendore (bashkëlidhur). Me qëllim realizimin e një raporti të posaçëm për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi me fokus të veçantë punësimin në administratës vendore të personave me aftësi të kufizuara., kërkojmë nga ana e institucionit tuaj plotësimin e pyetjeve bashkëlidhur, si dhe duke na mundësuar çdo informacion tjetër që ju e gjykoni të nevojshëm.</p>		<p>b) Me status te nëpunësit civil kemi gjithsej 48 (dyzet e tetë) punonjës. c) Brenda organikës së Institucionit tonë kemi të punësuar gjithsej 2 (dy) persona me aftësi të kufizuar si më poshtë: >Z. J.M me detyrë Përgjegjës Sektori i Emergjencave Civile.Ky pozicion pune nuk është me status nëpunësi civil. >Z.B.B me detyrë Korrier, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.Ky pozicion nuk është me statusin e nëpunësi civil, por është funksion ndihmës/administrativ d) Llojet e aftësisë së kufizuar për këta 2 (dy) persona janë si më poshtë: >Z.J.M me diagnozë Hemoragji Cerebrale i aftë për punë 6 (gjashtë) orë në ditë sipas vertetimit nga KMCAp. >Z.B.B me diagnozë Probleme të Shëndetit Mendor. e) Përshtatja në vendin e punës u është siguruar si në aspekt të sigurimit të transportit por ardhjen për tek vendi i punës ashtu edhe në</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>krijimin e kushteve të duhura brenda ambjenteve të punës.</p> <p>l) Përshtatja është realizuar plotësisht në shumicën e rasteve duke mos patur kosto shtesë për realizimin e saj, pasi ky proces është realizuar në koordinim me punonjësit e varësisë brenda institucionit.</p> <p>g) Nuk ka patur raste të mosofrimit të përshtatjes së arsyeshme.</p> <p>h) Këta 2 (dy) persona me aftësi të kufizuar janë marrë në punë nëpërmjet emërimit sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>i) Sqarohet se 1 (një) person Z.J.M është i punësuar me kohë të pjesshme 6 (gjashtë) orë në ditë, ndërsa personi tjetër Z.B.B është i punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		
10	30.05.2022	Aktualisht, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në fazën e hartimit të një ligji të ri, i cili do të bëjë të mundur kalimin tërësor	01.06.2022	Në përgjigje të shkresës suaj nr. 25 prot., datë 26.05.2022, protokolluar nga bashkia Malësi e Madhe me nr. 1623 Prot, datë 30.05.2022 “Kërkohet informacion mbi përjashtimet nga taksa e	Përfunduar	Nuk ka

		<p>të kësaj takse tek vlera e tregut.</p> <p>Me qëllim analizimin sa më të saktë të ndryshimeve që ky ligj i ri mendohet të sjellë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë ka të nevojshme dërgimin nga ana juaj të një informacioni sa më të plotë mbi numrin dhe sipërfaqen totale të pasurive të paluajtshme ndërtesa që bashkia juaj ka përjashtuar gjatë vitit 2021 të kategorizuar sipas pikës ë) dhe f) të nenit 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore”, i ndryshuar.</p>	<p>pasurisë “ndërtesë” tuaj ju informojmë se për Bashkinë Malësi e Madhe numri i të përjashtuarve për taksën e e pasurisë së paluajtshme ndërtesë gjatë vitit 2021, të kategorizuar sipas pikës ë) dhe 0 të nenit 22 të ligjit nr 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar është si më poshtë:</p> <p>Për kategorinë e ndërtesave të banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë të përjashtuara 800 familje. Për kategorinë e ndërtesave të banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/ pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë janë të përjashtuara 3170 familje. Bashkia Malësi e Madhe nuk disponon të dhëna për sipërfaqen totale të pasurive të paluajtshme ndërtesa të përjashtuara për vitin 2021 për kategorizimet sipas pikës ë) dhe f) të nenit 2022 të</p>		
--	--	--	---	--	--

				ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar. Faleminderit për bashkëpunimin!		
11	16.06.2022	Për nevoja të hetimit të procedimit penal Nr.746/2022, kërkohet të na informoni sa më poshtë: Me datë 11.05.2022, në vendin e quajtur “Bregu i liqenit” fshati Ivanaj, Njësia Administrative Kastrat Bashkia Malësi e Madhe, është gjetur parcela të kultivuara 107 bimë si ato narkotike. A rezulton ky vend, të jetë në pronësi të Bashkisë Malesi e Madhe apo pronë shtet?	01.07.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj nr prot 4838 datë 09.06.2022 protokolluar me tonë me nr prot 1792 datë 16.06.2022 drejtuar Bashkisë Malësi e Madhe ku kërkoni informacion në lidhje me statusin juridik të vendit të quajtur “Bregu i liqenit” ju informojmë që të dhënat që na keni dërguar janë të pamjaftueshme për identifikimin e kësaj prone. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.	Përfunduar	Nuk ka
12	16.06.2022	Të nderuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti koordinues për gjithëpërfshirjen sociale për grupet në nevojë si dhe në mbështetje të të moshuarve, monitoron zbatimin e Planit Kombëtar	06.09.2022	Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.2564 Prot datë datë 13.06.2022 “Kërkesë për informacion”, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr. 1795 Prot datë 16.06.2022, ju bëjmë me dije se në bashkinë tonë ka filluar të zbatohet projekti për të moshuarit në nevojë. Jane punësuar 3 punonjëse dhe kanë filluar punën	Përfunduar	Nuk ka

		<p>të Veprimit mbi Moshimin 2020-2024, miratuar me VKM Nr.864, datë 24.12.2019.</p> <p>Bazuar në Planin e Veprimit mbi Moshimin 2020-2024 dhe Ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016, "Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë", lutemi të dërgohet një informacion mbi shërbimet dhe mbështetjen që ofrohen për të moshuarit në nevojë. Njëkohësisht, të dërgohen dhe kontaktet për personat përgjegjës pranë institucionit tuaj, me fokus mbështetjen e grupit social të sipërpërmendur.</p>		<p>për evidenlimin e të moshuarve në nevojë. Konkretisht punonjëset e angazhuara në projekt janë:</p> <p>1.Ilda Rexhaj - Përgjegjëse e sektorit të Shërbimeve Sociale dhe përgjegjëse për projektin (Pozicion pune pa të drejte page)</p> <p>2.Samuella Omeraj- Infermiere</p> <p>3.Flutura Zaraj - Punonjëse Sociale</p> <p>4.Vilma Ujkaj - Sanitare</p>		
13	16.06.2022	<p>Për nevoja të hetimit të procedimit penal Nr.743/2022, kërkojmë të na informoni sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me datë 10.05.2022, në vendin e quajtur fshati "Goraj", Njësia Administrative Kastriot 	01.07.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj nr prot 4890 datë 10.06.2022 protokolluar me tonë me nr prot 1816 datë 16.06.2022 drejtuar Bashkisë Malësi e Madhe ku kërkonte informacion në lidhje me statusin juridik të vendit të quajtur fshati Goraj, ju informojmë që të dhënat që na keni dërguar janë</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Bashkia Malësi e Madhe, është gjetur parcela ku në të ishin hapur gropa dhe në të ishin mbjellë bimë si ato narkotike.</p> <p>A rezulton ky vend, të jetë në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe apo pronë shtetit.</p>		<p>të pamjaftueshme për identifikimin e kësaj prone.</p> <p>Bashkëlidhur do gjeni edhe informacion nga Njësia Administrative Kastrat në Bashkinë tonë.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.</p>		
14	24.06.2022	<p>Per nevoja te procedimit penal me numer 719/2022, kerkohet nga ana e juaj nje karakteristike e pergjithshme ne lidhje me shtetasin F.Z.P , i dtl.22.06.1967, lindur ne Plan-Gjuraj, dhe banues ne Boriç i Vogel, Njesia Administrative Gruemire , Bashkia Malesi e Madhe. Cfare sjelljeje ka ky shtetas ne komunitet, a eshte i punesuar, a trajtohet me ndihme ekonomike, si sillet ne komunitet dhe cdo informacion qe keni ne</p>	19.07.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj nr.5108 prot datë 17.06.2022, protokolluar në institucionin tonë me nr. 1889 datë 24.06.2022, mbi kërkesën për informacion në lidhje me shtetasin F. Z .P i dtl.22.06.1967, ju bëjmë me dije se pas verifikimeve të bëra si në zyrën e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Gruemirë, ashtu edhe në zyrën e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Malësi e Madhe na rezulton se ky shtetas nuk është banor i Bashkisë Malësi e Madhe. Theksojmë se ky shtetas nuk është i punësuar pranë institucionit të Bashkisë Malësi e Madhe, apo pranë ndonjë Drejtorie apo Ndërmarrje në varësi të saj, si pjesë e funksioneve të deleguara.</p> <p>Bashkëngjitur gjeni edhe kopjen e shkresës përcjellëse nr.663/1 prot</p>	Përfunduar	Nuk ka

		lidhje me kete shtetas , per menyren e sjelljes e jeteses se tij ne komunitet.		datë 05.07.2022 të Njesisë Administrative Gruemirë. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !		
15	29.06.2022	Në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar (në vijim “LAP”), mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”). APP, në ushtrimin e funksioneve në fushën e ankandëve publike, verifikon zbatimin e procedurave të ankandëve, pas nënshkrimit të kontratës në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve shitëse të gjithë informacionin e nevojshëm.	25.07.2022	Në zbatim të nenit 7 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar (në vijim “LAP”), me shkresën Nr. 4467 Prot., datë 27.06.2022, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), ka kërkuar nga autoriteti juaj shitës informacion mbi arsyet e mosdërgimit të raportimit 6-mujor, sipas nenit 6/4 të LAP, si dhe mbi ecurinë/ finalizimin e procedurës së shpallur të ankandit në vitin 2021. Në vijim, me shkresën Nr. 1929/1 Prot., datë 07.07.2022, keni dërguar informacion mbi veprimtarinë e ankandëve të zhvilluara gjatë vitit 2021, ku rezulton se autoriteti juaj shitës ka zhvilluar vetëm një procedurë ankandi, e cila është finalizuar me nënshkrim kontrate. Gjithashtu, sqaroni se arsyeja e mos	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Në pikën 4, të nenit 6 të LAP, parashikohet se: “Autoriteti shitës, çdo 6 muaj, duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtaritë e tij të ankandit. Formatit dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e ankandit”.</p> <p>Nga Buletini i Njoftimeve Publike të publikuara, APP ka konstatuar se, në vitin 2021 autoriteti juaj shitës ka shpallur 1 procedurë ankandi, por nuk rezulton të ketë respektuar përcaktimet e dispozitave të sipërcituara, mbi detyrimin për raportim të veprimtarive të ankandëve të realizuara.</p>		<p>raportimit të kësaj procedure është mospërcaktimi i formatit të raportimit në rregullat e ankandit publik sipas pikës 4, të nenit 6 të LAP.</p> <p>Për sa cilësohet nga ana juaj, APP sqaron se, pavarësisht formatit të raportimit autoritetet shitëse kanë detyrimin të raportojnë çdo 6 muaj për procedurat e ankandit të zhvilluara, në përputhje me pikën 4, të nenit 6 të LAP, ku parashikohet se: “Antoriteti shitës, çdo 6 muaj duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtaritë e tij të ankandit. Formatit dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e ankandit”.</p> <p>Sa më sipër, APP tërheq vëmendjen e autoritetit tuaj shitës për respektimin e detyrimit në të ardhmen, për raportimin çdo 6 muaj, të veprimtarive të ankandëve të realizuara.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.</p>		
16	29.06.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” neni	06.07.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 16717, Prot, datë 21.06.2022, protokolluar nga Bashkia Malësi e	Përfunduar	Nuk ka

		49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: V.M		Madhe me nr. 1934 Prot, datë 29.06.2022 “Kërkim informacioni,, , ju informojmë se subjekti V.M person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me administrator znj.V M regjistruar me datë 08/09/2014në QKR, me aktivitet në fushën “Tregtim artikuj ushqimor”, me adresë Shkoder Gruemire GRILE Komuna Gruemire,Rruga Nacionale Grile- Hani Hotit, Qender Grile, godine I-kateshe, nr. 3, Malësi e Madhe, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe.		
17	07.07.2022	I/E nderuar Z/Zj. Kryetar/e! Në kuadër të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, bazuar në pikën 6 të dispozitave të përgjithshme të vkm-së nr.302, datë 11.05.2022 me	19.07.2022	I nderuar Z.Jahaj, Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.1334 Prot datë 01.07.2022, protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1999 Prot datë 07.07.2022,mbi kërkesën për informacion,bazuar në VKM nr.302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë,largimit,trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” bazuar në pikën 6 të dispozitave të përgjithshme të kësaj VKM-je, ju bëjmë me dije se personi i propozuar si anëtar i Këshillit	Përfunduar	Nuk ka

		<p>qëllim krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta të Ujësjetës-Kanalizimeve (SPK-UK) kërkohen propozim nga ju për 1 (një) anëtar të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë së re që do të krijohet.</p> <p>Bazuar në Statutin Tip të shoqërisë i cili është pjesë integrale e VKM-së Nr. 302 datë 11.05.2022, anëtar i Këshillit Mbikqyrës duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomistë ose juristë -Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektivin e veprimtarisë së shoqërisë. <p>Secili prej individëve të propozuar duhet të dorëzojë CV për të vërtetuar përputhshmërinë me kriteret e mësipërme.</p>		<p>Mbikqyrës të shoqërisë së Ujësjetës-Kanalizimeve nga ana e institucionit Bashkia Malësi e Madhe është z. Altin Rrukaj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, me profesion Ekonomist me një përvojë punë më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare.</p> <p>Bashkëngjitur gjeni edhe një kopje të CV-se se tij së bashku me dokumentat e njehësura me vulën e institucionit tonë.</p> <p>Duke iu falenderuar për mirëkuptimin.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

18	07.07.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.Sh", neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: B.U	13.07.2022	Ne përgjigje të shkresës suaj Nr. 17451 .Prot, datë 28.06.2022 "Kërkini informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhc me Nr.2000 Prot, datë 07.07.2022, ju informojmë se subjekti B.U person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator z. B.U rregjistruar me datë 26/01/2016 në QKR, me aktivitet në fushën Bar-Kafe, me adrcsë Shkoder Koplik, Lagjja Qender, Rruga Koplik i Siper, godine 1-kateshe, nr pasurie 36, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !	Përfunduar	Nuk ka
19	07.07.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.Sh", neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar; N.Z	13.07.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 17713.Prot, datë 30.06.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.2002 Prot, datë 07.07.2022, ju informojmë se subjcti N Z person fizik me numër Nipti:XXXXXXXXXX me administrator z. N.Z rregjistruar me datë 08/12/2004 në QKR, me aktivitet në fushën shërbim i pijeve, me adresë Vrakë, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !		Nuk ka

20	07.07.2022	<p>I/E nderuar Z/Zj. Kryetar/e ! Në kuadër të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, bazuar në pikën 6 të Dispozitave të Përgjithshme të VKM-së Nr.302, datë 11.05.2022 me qëllim krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve (SPK-UK) kërkohet informacion i saktë mbi numrin e kontratave aktive që marrin shërbim ujësjellës-kanalizime në territorin e Bashkisë tuaj. Në numrin e kontratave që do deklaroni do të jetë si më poshtë: >Numri i kontratave që administrohen nga vetë Bashkia</p>	22.08.2022	<p>Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1330 Prot., datë 01.07.2022 administruar pranë institucionit tonë me date 07.07.2022 me nr.2003 Prot., ku keni kërkuar informacion mbi numrin e kontratave aktive që marrin shërbim ujësjellës-kanalizime ju informojmë se : - Bashkia Malësi e Madhe si institucion nuk administron asnjë kontratë të tillë. -Numri i kontratave që administrohen nga vetë Ujësjellës Kanalizime Sh.a brenda territorit të Bashkisë Malësi e Madhe është 5.824 abonent dhe numri total i kontratave aktive është po ashtu 5.824. Faleminderit për mirekuptimin !</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	------------	--------

		o Numri total i kontratave aktive >Numri i kontratave që administrohen nga vete Sh.a Ujësjetës - Kanalizime brenda juridiksionit të Bashkisë përkatëse.				
21	07.07.2022	Pranë Zyrë E Përmbarrimit Privat 616/A, është vënë në ekzekutim Vendimi Nr .7394 Dt.16,11,2021 Gjykata Rrethit Gjyqësorë Tirane. Është depozituar pranë ZYRË E PËRMBARRIMIT PRIVAT 616/A, kërkesa e kreditorit "D & A FIN PARTNER" SHPK me Nr. Nipt XXXXXXXXXXXX, së bashku me titullin ekzekutiv me palë: Kreditor:"D & A FIN PARTNER" SHPK me Nr. Nipt XXXXXXXXXXXX Debitor: B.T.D me dtl. 25,02,1962 me ID XXXXXXXXXXXX Objekti:Pagim detyrimi +shpenzime gjyqesore	19.07.2022	I nderuar z.Mato, Në mbështetje të shkresës tuaj Nr.522/1 Regj datë 27.06.2022, protokolluar në institucionin tonë me Nr.2004 Prot datë 07.07.2022, mbi kërkesën për informacion mbi adresën e saktë të debitorit B.T. D i dtl 25.02.1962 me nr 1D XXXXXXXXXXXX ju bëjmë me dije se sipas të dhënave të marra nga zyra e gjendjes civile pranë Bashkisë Malësi e Madhe shtetasi në fjalë ka këte adresë vendbanimi si më poshtë: Njesia Administrative Qendër; rruga: Kanali i Rragamit nr.8; Banca iiumër 8; kodi postar 4303; Bashkia Malësi e Madhe.	Përfunduar	Nuk ka
22	07.07.2022	Ne kuader te ofrimit te shërbimit shëndetësor parësor ndaj komunitetit Ju	15.07.2022	Në pergjigje të shkreses suaj 121 date 06.07.2022 protokolluar me tonen me 2008 prot. datë	Përfunduar	Nuk ka

		<p>kërkojme informacion mbi paraqitjen gjeografike te fshatrave Zagore,Vrith,Razem dhe Pojice,karakteristikat e shtëpive largësite me njëra-tjetrën ,gjendjen e infrastrukturës rrugore Jargësitë nga qendra e njësisë Administrative Shkrel.</p> <p>Ju falenderojme për bashkëpunimin.</p>		<p>07.07.2022 në lidhje me terrenin gjeografik të fshatrave Zagore, Vrith, Razem, Vuç-Kurtaj dhe Pojice.</p> <p>Ju informojme se, kjo zone karakterizohet me terren mjaft të veshtire si dhe fshatrat janë larg nga njeri tjetri. Infrastruktura rrugore nuk është në gjendje shumë te mire si dhe kanë një distance të konsiderushme nga njesia administrative Shkrel e cila ndodhet në Dedaj.</p> <p>Ju faleminderit per bashkepunimin.</p>		
23	16.08.2022	<p>Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Rcgjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion ne lidhje me detyrimet tatimore për subjcktin e poshtëshënuar: N.B</p>	01.09.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj Nr.20851 .Prot, datë 10.08.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.2293 Prot, datë 16.08.2022, ju informojmë se subjekti N.B person fizik me numër Nipti:XXXXXXXXX me administrator z. N.B rregjistruar me datë 09/12/2021 në QKR, me aktivitet në fushën Bar- Restorant, Bujtine, me adresë Shkoder Koplik, Rruga Culaj, Godine 2-kateshe, Zona Kadastrale 2220, Nr.pasurie 704/3, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe.</p>	Përfunduar	Nuk ka

24	13.09.2022	<p>Për nevoja të hetimit të procedimit penal Nr.280 /2022, kërkohet nga ana juaj informacion lidhur me si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të na informoni nëse gjatë verifikimeve nga policia bashkiake është konstatuar në ndonjë rast hedhja e mbetjeve/inerteve në token e shtetasit A.D pronë e ndodhur në aksin rrugor Koplik-Shkodër, Lagjia: "Llazan". o Të na konfirmoni nëse për konstatimet e bëra është njoftuar shtetasi A.D dhe nëse janë marrë masa të tjera nga ana e Bashkisë Malësi e Madhe dhe cilat kanë qenë ato. Për efekt të afatcve hetimore presim përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur. 	20.09.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me nr.7093 Prot ,datë 19.09.2022 dhe protokolluar me tonën me Nr.2650 Prot, date 13.09.2022 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion pronen e shtetas A.D e ndodhur ne aksin rrugor Shkoder-Koplik, Lagja "Llazan", Nj.Ad Koplik,Bashkia Malësi e Madhe:</p> <p>Ju informojme se në pronen e shtetasit A.D e ndodhur ne aksin rrugor Shkoder- Koplik, Lagja "Llazan", Nj.Ad Koplik, Bashkia Malësi e Madhe:</p> <p>Nuk janë marrë masa nga ana e IVMT-së apo Policisë Bashkiake.</p>	Përfunduar	Nuk ka
25	22.09.2022	<p>Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhc në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat</p>	26.09.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj Nr.23685.Prot, datë 15.09.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe rne Nr.2765 Prot, datë 22.09.2022, ju informojmë se subjekti Y. K person</p>	Përfunduar	Nuk ka

		Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: Y.K		fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me administrator znj. Y.K rregjistruar me datë 25/03/2022 në QKR, me aktivitet në fushën Tregti online, me adresë Shkoder Koplik, Qendër, Bogiç-Palvar, Nr 36,Rruga Kurtaj 03690045 4303, nuk ka dotyrimet fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !		
26	22.09.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: E.K	26.09.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.23568.Prot, datë 14.09.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.2766 Prot, datë 22.09.2022, ju informojmë se subjekti E.K person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me admistrador z. E.K rregjistruar me datë 17/02/2020 në QKR, me aktivitet në fushën Import- eksport, shit - blerje e automjeteve, dhenie e makinave me qira., me adresë Shkoder Koplik Rruga nacionale Shkoder -Koplik, ndertese me nr 1029, zona kadastrale 2220 4001, ka detyrimet fiskale vendore në shumën 18000 lekë ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !	Përfunduar	Nuk ka

27	22.09.2022	<p>Të nderuar përfaqësues të Bashkisë, Qendra për Nisma Ligjore Qyellare (QNL) po zbaton projektin "Advokaci për një akses selektiv të viktimave të dhunës në familje në ndihmën ekonomike", me mbështetjen e Agjensisë Austriake për Zhvillim (ADA) nëpërmjet A\VEN</p> <p>Po paraqesim kete kërkesë për informacion në lidhje me pyetjet si më poshtë:</p> <p>1)A kanë përfituar ndihmë ekonomike viktimat e dhunës në familje që kanë aplikuar pranë administratorit shoqëror nga data 1-10 e muajit, pavarësisht se vendimi i gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes ose Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes nuk ka qenë i formës së prerë?</p> <p>2)Sa raste janë mbështetur me ndihmë ekonomike për periudhën Gusht-Shtator 2022 që kanë qenë të</p>	29.09.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion të datës 19/09/2022 me nr prot 266 mbi monitorimin e aksesit të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare në ndihmen ekonomike, arrijtjet dhe sfidat ju informojmë se:</p> <p>1.A kanë përfituar ndihme ekonomike viktimat e dhunës në familje që kanë aplikuar pranë administratorit shoqëror nga data 1-10 e muajit, pamvarsisht t se vendimi i gjykatës për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes ose Urdhërit të Menjëhershëm të mbrojtjes nuk ka qenë i formës së prerë? Viktimat e dhunës në familje nuk kanë përfituar nga ndihma ekonomike kur ato kanë patur vetem urdher të menjëhershëm të mbrojtjes, deri në një vendim të dytë të formës së prerë nga gjykatata.</p> <p>2.Ashtu sic u citua dhe më sipër asnjë urdher menjëhershëm mbrojtje nuk është trajtuar me ndihmë ekonomike, pa u marr forma e prerë e vendimit të gjykatës.</p> <p>3.Pas datës 10 të muajit asnjë nga viktimat e dhunës në familje nuk ka</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	------------	--------

		<p>pajisur me vendime të gjykatës të urdhrave të mbrojtjes që nuk kanë marrë formë të prerë?</p> <p>3)A i është dhënë e drejta qytetarëve që për rastet kur UM ose UMM është lëshuar nga gjykata pas datës 10 të muajit, të aplikojnë në muajin pasardhës dhe e drejta e përfitimit a ju është njohur përgjatë gjithë periudhës së së vlefshmërisë së UM ose të UMM pa humbur përfitimin e muajit përkatës në të cilin është lëshuar UM apo UMM nga gjykata?</p> <p>4)Nëse po, sa raste të viktimave të dhunës në familje në situatën e pikës 3 më lart kanë përfituar për periudhën Gusht-Shtator 2022?</p> <p>5) Sfida në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të fundit të SI ISSH?</p>		<p>përfituar nga ndihma ekonomike sepse vete sistemi nuk e lejon aplikimin pas kësaj date.</p> <p>5.Sfida në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të fundit të SHSSH? Sfida më e madhe që do veconim do ishte fakti që të na lejoj sistemi që dhe pas datës 10 të muajit ne të mund të bëjme aplikimin për ndihmen ekonomike në rastet e UM në mënyrë që mos të kaloj muaji pa u trajtuar me ndihmen ekonomike.</p>		
28	22.09.2022	Në lidhje me veprimet hetimore paraprake që po	23.09.2022	Për sa kërkonte në shkresën tuaj Nr. 7339 Prot. Date 17.09.2022 si dhe	Përfunduar	Nuk ka

		<p>kryhen për procedimin penal nr.1308 të vitit 2021 nevojitet nga ana e juaj të na konfirmohet nëse vendi i quajtur:Pylli i Jugomirës,në Njësinë Administrative Rrapsh,Bashkia Malësi e Madhe(N:42° 22' 31 ",E:19° 30' 24") i përket një parcelë nën administrimin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Shkodër,dhe në rast se po të na furnizohen gjeneralitetet dhe adresa e saktë e vendbanimit e inspektorit të pyjeve që mbulon këtë zonë duke specifikuar dhe datën e marrjes së kësaj detyre nga ana e tij.</p>		<p>ne shkresen nr 7340 date 17.09.2022 e administruar nga ana jone me shkresen Nr. 2783Prot. e 2784 te dates 22.09. 2022 ju sqarojmë si me poshtë : Vendi i quajtur “Lagje “ Jugomire ”Fshati Bratosh, me koordinata 42 22’ 31” ; 19 30’ 24” ne Njësinë Administrative Kastrat ndodhet ne toke bujqesore jashtë fondit pyjor si rrjedhim Inspektoret e Pyjeve nuk i kane ne juridiksionin e tyre. Bashkëngjitur ju dërgojmë edhe hartën e territorit ku gjendet vendi i përshkruar si me sipër. Faleminderit për mirëkuptimin.</p>		
29	26.09.2022	<p>Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me</p>	28.09.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 24104, Prot, datë 19.09.2022, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr.2809 Prot, datë 26.09.2022 “Kërkim informacioni,, , ju informojmë se subjekti A.H person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator z.A.H regjistruar me datë 27/08/2020 në QKR, me aktivitet në fushën “ Byrektore”, me</p>	Përfunduar	Nuk ka

		detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshëmiar; A.H		adresë: Shkoder Koplik KOPLIK Koplik, Rruga Koplik Qender, perballe bashkise, ndertesa nr.12, Malësi e Madhe, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe.		
30	26.09.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.Sh", neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: I.K	28.09.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 24584, Prot, datë 21.09.2022, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr.28U Prot, datë 26.09.2022 "Kërkim informacioni,, , ju informojmë se subjekti I.K person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXX me administrator z.I.K regjistruar me datë 07/09/2015 në QKR, me aktivitet në fushën " Bar kafe ", me adresë: Shkoder KOPLIK Lagjja Qender, Rruga Koplik i Siperme, nr pasurie 25, zona kadastrale 2220, Malësi e Madhe, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe.	Përfunduar	Nuk ka
31	30.09.2022	Në mbështetje të ligjit Nr.20 datë 07.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive në Republikën e Shqipërisë "neni 69, pika 9 , si dhe VKM nr. 1178, dt 24.12.2020 "Për përcaktimin e	04.10.2022	Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 10004 Prot ,datë 27.09.2022 dhe protokolluar me tonën me Nr.2879 Prot, date 03.10.2022 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi objektin në pronën e shtetasit I. Z.C e ndodhur ne Razem,njs Adm Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe:	Përfunduar	Nuk ka

		<p>dokumentacionit dhe rregullave te hollesishme të evidcntimit të ndërtimeve pa leje", si dhe në baze të ligjit 107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit" të ndryshuar kerkojme:</p> <p>► Informacion nga anaj uaj nëse objekti qe ka ndertuar subjekti I.Z.C i ndodhur ne Razem, Nj. Adm. Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe,Qarku Shkoder, Zk.3834 dhe me nr. Pasurie 185/1, banese 2(dy) kate është vendosur më parë prishja apo konfiskimi ose ka pasur dënime sipas nenit 46 të ligjit nr. 10279/2010 "Per kundërvajtjet administrative".</p>		<p>Ju informojme se në pronen e shtetasit I.Z.C e ndodhur në Razem, njs Adm. Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe nuk janë marre masa as denime sipas Nenit 46 Te Ligjit Nr. 10279/2010 “Per kundërvajtjet administrative” nga ana e IVMT-së.</p>		
--	--	--	--	---	--	--